

Бр.№. 09-267/1
23-1 2025 год. viti
СКОПЈЕ - ШКУР



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e zhvillimit të arsimit
Ministry of Education and Science - Bureau for Development of Education

Byroja e Zhvillimit të Arsimit në kuadër të kompetencave dhe aktiviteteteve të planifikuara në Programin për mbrojtjen e konsumatorëve për vitin 2025, i përgatitur në pajtim me nenin 170 dhe nenin 171 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 236/22) me rastin e 15 Marsit Ditës Botërore të së Drejtave të Konsumatorëve dhe nën moton për vitin 2025 "Tranzicioni i drejtë në një mënyrë jetese të qëndrueshme" shpall

KONKURS PËR ART FIGURATIV
për fëmijët e kopshteve dhe për nxënësit e
shkollave fillore dhe të mesme

Qëllimi i konkursit të artit figurativ është që fëmijët dhe nxënësit të shprehin në mënyrë krijuese mendimin e tyre kritik që ka të bëjë me konsumin e qëndrueshëm, përkatësisht për nevojën urgjente për ndryshime thelbësore në mënyrën se si ushqehemi, si udhëtojmë, si i ngrohim dhe freskojmë shtëpitë tona, cilat produkte dhe shërbime, blejmë dhe përdorim. Tranzicioni i drejtë nuk ka të bëjë me të drejtat dhe nevojat themelore të njerëzve, por është një mundësi për përparim, duke ofruar një mënyrë jetese të qëndrueshme për njerëzit, por edhe për planetin.

Konkursi i Artit figurativ organizohet në 4 (katër) kategori:

1. Tema: "MOS I HIDH LODRAT, DHUROI ME DASHURI"
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë fëmijët e moshës 4-6 vjeç që përdorin shërbimet e një kopshti publik.
2. Tema: "ZERO MBETJE USHQIMORE - JETESË MË E MIRË DHE E SHENDETSHME"
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë nxënësit e arsimit fillor (mësimi klasor) - nga klasa e I (e parë) deri në klasën V (e pestë).
3. Tema: "VESHU ME MENÇURI - MODË E QËNDRUESHME"
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë nxënësit në arsimin fillor (mësimi lëndor) - nga klasa VI (e gjashët) deri në klasën IX (e nëntë).
4. Tema: "TRANSPORTI I QËNDRUESHËM - ZGJIDHJE PËR NJË TË ARDHME TË GJELBËR"
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë nxënësit në arsimin e mesém - nga viti I (i parë) deri në vitin IV (e katërt).

MËNYRA DHE AFATI I PARAQITJES:

- Vepra figurative - artistike duhet të jetë punë e pavarur e nxënësit.
- Një nxënës mund të dërgojë **vetëm një** vepër figurative individuale.
- Krijimi figurativ duhet të bëhet në format dydimensionale dhe në teknika artistike dhe kombinime të tyre të përshtatshme për moshën e fëmijëve/nxënësve (teknika e flomasterit nuk do të merret parasysh).
- Krijimi duhet të nënshkruhet vetëm në anën e pasme.
- Çdo krijim figurativ duhet të skanohet në një nga formatet: JPG, TIFF (**formatet PDF dhe fotografitë e punimeve nuk do të merren parasysh**).
- Fajlli me veprën artistike duhet të numërohet.
- Të dhënat për krijimet figurative duhet të vendosen në tabelë (për shkarkimin e të dhënave të sakta të plotësuara dhe të dërguara në Word në mënyrë elektronike – emri i autorit/fëmijës/nxënësit; mosha/klasa/viti; titulli i veprës; teknika e përdorur; emri i edukatorit/mësimdhënësit mentor; kontakti i edukatorit/mësimdhënësit mentor).
- Dosjet me krijimet figurative duhet të vendosen në një dosje me emrin e institucionit që dërgon.
- Dosjen e zipuar paraprakisht, përmes postës elektronike (për shkak të madhësisë së përbajtjes përmes WETRANSFER, SENDSPACE, etj.), Institucioni Juaj duhet ta dërgoj me email në adresën elektronike info@bro.gov.mk, me shënimin: **Për konkursin e artit figurativ**.
- Numri maksimal i krijimeve të artit figurativ **është 3 (tre)** nga çdo institucion.
- Afati për dorëzimin e krijimeve të artit figurativ është më së voni deri më **21 shkurt (e premte)**.
- Veprat e artit figurativ që nuk plotësojnë dhe ndjekin propozimet e mësipërme, si dhe ato të paraqitura pas afatit të caktuar, nuk do të merren parasysh.

Pjesëmarrësit e shpërblyer të konkursit të artit (**vendi i parë, i dytë dhe i tretë**) nga çdo kategori do të shpalen veçmas në faqen e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit më **14 mars 2025**.

Për pyetje në lidhje me konkursin kontaktoni personin mr. Valentina Gocevska në email adresën valentinagocevska@bro.gov.mk.

Ju mirëpresim!
Byroja e Zhvillimit të Arsimit